



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT  
DHE SPORTIT  
AGJENCIA KOMBËTARE E PROVIMEVE

Nr. 3749 Prot.  
(Lutemi referojuni në rast përgjigje)

Tiranë, më 27 10, 2014

URDHËR

Nr. 46, datë 27 10, 2014

PËR

**MIRATIMIN E RREGULLORES "PËR PËRZGJEDHJEN E BASHKËPUNËTORËVE TË JASHTËM"**

Në mbështetje të Ligjit nr. 69, datë 21.06.2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", Ligjit nr. 9741, datë 21.05.2007 "Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, Ligjit nr. 10171, datë 22.10.2009 "Për profesionet e rreguluara në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, Ligjit nr. 7850, datë 29.07.1994, "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr., 1013, datë 10.12.2010, "Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Provimeve", Statutit dhe Rregullores së brendshme të AKP-së,

URDHËROJ:

1. Miratimin e Rregullores "Për përzgjedhjen e bashkëpunëtorëve të jashtëm", sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij urdhri.
2. Ngarkohet Agjencia Kombëtare e Provimeve për zbatimin e saj.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

  
Rezana VRAPI  
DREJTOR I PËRGJITHSHËM



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**MINISTRIA E ARSIMIT**  
**DHE SPORTIT**  
**AGJENCIA KOMBËTARE E PROVIMEVE**

3749/1  
Nr. \_\_ Prot.

Tiranë, më 24.10.2014

**MIRATOHET**

**DREJTORI I PËRGJITHSHËM**

**REZANA VRAPI**



**RREGULLORE E BRENDSHME**  
**PËR PËRZGJEDHJEN E BASHKËPUNËTORËVE TË JASHTËM**

**TIRANË**

## **Neni 1**

### **Objekti**

1. Kjo Rregullore ka për objekt përcaktimin e procedurës së përzgjedhjes së bashkëpunëtorëve të jashtëm, të cilët duhet të angazhohen në përbushje të fushës së veprimtarisë së "Agjencisë Kombëtare të Provimeve", (më poshtë AKP) në përputhje me objektivat dhe misionin ligjor të saj.
2. Kjo Rregullore përcakton kuadrin e brendshëm juridik të nevojshëm për mbarëvajtjen e veprimtarisë së institucionit, duke siguruar kriteret dhe rregullat të njëjta për kandidatët, bashkëpunëtorët e institucionit, si dhe duke garantuar pjesëmarrjen aktive të tyre në procesin e aktiviteteve të kësaj Agjencie.

## **Neni 2**

### **Baza ligjore**

Kjo Rregullore mbështetet në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Ligjin për Arsimin e Lartë, i ndryshuar, Ligjin për Arsimin Parauniversitar, i ndryshuar, Kodin e Punës, Kodin e Procedurave Administrative, Ligjin për profesionet e rregulluara, i ndryshuar, Ligjin "Për të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të", i ndryshuar, Ligjin "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", i ndryshuar, VKM nr.78, datë 08.02.2006, "Për krijimin e Maturës Shtetërore dhe pranimet në shkollat e larta", i ndryshuar, VKM nr.120, datë 27.01.1997, "Për shpërblimin e autorëve të veprave shkollore, teksteve shkollore dhe materialeve të tjera të dokumentacionit shkollor, VKM-në nr. 812, datë 10.11.2011, "Për përcaktimin e tarifave për provimin e shtetit", VKM-në nr.1013, datë 10.12.2010 "Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Provimeve", Rregulloren e Ministrit përgjegjës për arsimin për procesin e Maturës Shtetërore, Rregulloren "Për organizimin e provimeve të shtetit për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, Rregulloren "Për funksionimin e Komisionit të Provimit të Shtetit për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë", Udhëzimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës nr.24, datë 02.08.2013, "Për certifikimin e hartuesve të testeve dhe vlerësuesve në provimet kombëtare", Statutin dhe Rregulloren e AKP-së dhe në gjithë legjislativonin në fuqi.

## **Neni 3**

### **Subjektet**

Subjekte të kësaj Rregulloreje janë hartuesit e fondit të pyetjeve, vlerësuesit në provimet kombëtare, anëtarët e Komisioneve të Provimit të Shtetit për profesionin e rregulluar dhe bashkëpunëtorët e tjerë, të cilët kërkojnë të ofrojnë shërbimet e tyre për të ndihmuar AKP-në në realizimin e funksioneve të saj.

## **Neni 4**

### **Kandidat për hartimin e fondit të pyetjeve dhe vlerësuesve në provimet kombëtare**

1. Mbështetur në Udhëzimin nr. 24, datë 02.08.2013 "Për certifikimin e hartuesve të testeve dhe vlerësuesve në provimet kombëtare", kandidati për hartimin e fondit të pyetjeve dhe vlerësuesve në provimet kombëtare, më tutje "Kandidati" është mësuesi që:

- a) Zotëron diplomën universitare në mësuesi për lëndën përkatëse;
  - b) Ka dhënë lëndën të paktën një herë në të gjitha klasat e arsimit të mesëm të lartë;
  - c) Ka 5 vjet përvojë si mësues në shkollën e mesme;
  - d) I është nënshtruar provimit të kualifikimit dhe është vlerësuar me të paktën me "mirë" në këtë provim. Parapëlqehen mësuesit që janë vlerësuar me "shumë mirë".
2. Mbështetur në Udhëzimin e mësipërm, kandidati për hartues të fondit të pyetjeve dhe vlerësues në provimet kombëtare paraqet pranë AKP-së:
    - a) CV-në sipas modelit bashkëlidhur Udhëzimit të mësipërm;
    - b) Dy rekomandime nga drejtues të shkollave ose specialistë të njësive arsimore vendore për cilësinë e punës së tij dhe etikën e tij profesionale.

## Neni 5

### Përzgjedhja e kandidatëve

1. Kandidatët për hartimin e fondit të pyetjeve ose për vlerësimin në provimet e maturës shtetërore:
  - a) marrin pjesë në kursin afatshkurtër të zhvilluar nga specialistë të AKP-së;
  - b) i nënshtrohen provimit me teste të hartuara nga AKP-ja;
  - c) pajisen me certifikatën përkatëse kur përfundojnë me sukses provimin.
2. AKP-ja duhet të:
  - a) publikojë në faqen e saj të internetit materialet për hartimin e testeve lëndore dhe vlerësimin;
  - b) datat e kurseve afatshkurtra që zhvillohen nga AKP dhe DAR/ZA-ja;
  - c) datat e provimeve dhe vendin e zhvillimit të tyre për AKP-në.
3. AKP harton dokumentin që përshkruan:
  - a) procedurat e zhvillimit të provimit të kandidatëve;
  - b) procedurat e vlerësimit të kandidatëve;
  - c) formatin dhe përmbajtjen e certifikatës të lëshuar nga AKP.
4. Provimi i kandidatëve zhvillohet në ambientet e AKP-së. Pyetjet janë në kompetencë të AKP-së. AKP brenda një jave nga përfundimi i provimit kryen vlerësimin e kandidatëve dhe shpall rezultatet.
5. Kanë të drejtë të hartojnë fondin e pyetjeve dhe të vlerësojnë në provimet kombëtare vetëm mësuesit e certifikuar sipas këtij udhëzimi.
6. AKP përzgjedh për një vit shkollor mësuesit e certifikuar prej saj si hartues të fondit të pyetjeve dhe vlerësues në maturën shtetërore.
7. Certifikata e kandidatëve fitues lëshohet nga AKP për hartimin e fondit të pyetjeve dhe vlerësimin në provimet e maturës shtetërore.
8. Certifikata është e vlefshme për një periudhë pesëvjeçare.
9. Trajtimi financiar i hartuesve të fondit të pyetjeve dhe vlerësuesve të provimeve të Maturës Shtetërore të kryhet sipas dispozitave në fuqi.

## Neni 6

### Përmbajtja e certifikatës

1. Certifikata përmban të dhënat e mëposhtme:
  - a) Stemën e Republikës së Shqipërisë;
  - b) Emërtimin: "Republika e Shqipërisë";

- c) Emërtimin "Ministria e Arsimit dhe Sportit";
  - d) Emërtimin "Agjencia Kombëtare e Provimeve";
  - e) Emërtimin e certifikatës;
  - f) Emrin, atësinë dhe mbiemrin;
  - g) Datëlindjen dhe vendlindjen;
  - h) Bazën ligjore ku mbështetet dhënia e këtij dokumenti, (Udhëzimin nr.24, datë 02.08.2013 "Për certifikimin e hartuesve të testeve dhe vlerësuesve në provimet kombëtare);
  - i) Nënshkrimin e Drejtorit të Agjencisë Kombëtare të Provimeve dhe vulën e AKP;
  - j) Datën e lëshimit;
  - k) Numrin.
2. Certifikata për hartuesit e fondit të pyetjeve/vlerësuesit në provimet e Maturës Shtetërore përmban një numër unik për çdo kandidat, i cili përbëhet nga 7 shifra dhe tre germa, ku dy shifrat e para tregojnë vitin e dhënies së provimit, tre gjerat e dyta kodin për hartuesit e fondit të pyetjeve/vlerësuesit në provimet e Maturës Shtetërore dhe pesë shifrat e tjera numrin individual të kandidatit, sipas shtojcës 1, bashkëlidhur kësaj Rregulloreje.
  3. Modeli i Certifikatës për hartuesit e fondit të pyetjeve/vlerësuesit në provimet e Maturës Shtetërore është sipas shtojcës nr. 2, bashkëlidhur kësaj Rregulloreje.

## Neni 7

### Përzgjedhja e operatorëve

1. AKP-ja përzgjedh operatorët e provimeve të Maturës Shtetërore sipas listave të dërguara nga DAR/ZA-të për çdo qendër vlerësimi.
2. Ata duhet të kenë eksperiencë pune në sistemet informatike të hedhjes së të dhënave dhe të pasqyrojnë me saktësi të dhënat që kërkohet të hidhen në sistem.
3. Për kryerjen e procedurave të seleksionimit dhe përzgjedhjes të kandidatëve sipas listave të dërguara nga DAR/ZA-të për çdo qendër vlerësimi, Drejtori i Përgjithshëm i AKP-së me urdhër ngre komisionin përkatës. Komisioni duhet të ketë në përbërje minimalisht 5 anëtarë, nga të cilët njëri duhet të jetë nga Drejtoria përkatëse ku duhet ofruar shërbimi dhe tjetri specialist i fushës përkatëse që ka lidhje me profilin e kandidatit si bashkëpunëtor. Komisioni vlerëson nëse procedura do të kryhet me konkurrim mbi bazën e dosjeve të kandidatëve apo me testim.
4. Në përfundim të procesit komisioni merr vendim për shpalljen e fituesve.
5. Anëtarët e Komisionit, përpara se të bëjnë përzgjedhjen e kandidatëve, duhet të nënshkruajnë një deklaratë që nuk ndodhen në kushtet e konfliktit të interesit me personat pjesëmarrës si bashkëpunëtorë të jashtëm.
6. Trajtimi financiar i operatorëve të kryhet sipas dispozitave në fuqi.

## Neni 8

### Lidhja e kontratave

AKP-ja lidh kontratë me hartuesit e fondit të pyetjeve, vlerësuesit e provimeve kombëtare, operatorët e provimeve të Maturës Shtetërore dhe bashkëpunëtorët e tjerë të jashtëm të saj.

## Neni 9

### Hartuesit e fondit të pyetjeve të Provimeve të Shtetit

Hartuesit e fondit të pyetjeve të Provimeve të Shtetit caktohen me urdhër të Ministrit përgjegjës për arsimin dhe i kryejnë detyrat në përputhje me Ligjin nr.10171, datë 22.10.2009 "Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, të VKM-së nr.812, datë 10.11.2011 "Për përcaktimin e tarifave për provimin e shtetit", të Rregullores "Për organizimin e Provimeve të Shtetit për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, të Rregullores "Për funksionimin e Komisionit të Provimit të Shtetit për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë". Trajtimi financiar i hartuesve të fondit të pyetjeve të Provimit të Shtetit kryhet sipas dispozitave në fuqi.

## Neni 10

### Anëtarët e Komisioneve të Provimeve të Shtetit

Anëtarët e Komisioneve të Provimeve të Shtetit caktohen dhe i kryejnë detyrat sipas rregullave të parashikuara në Ligjin nr.10171, datë 22.10.2009 "Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, të VKM-së nr.812, datë 10.11.2011 "Për përcaktimin e tarifave për provimin e shtetit", të Rregullores "Për organizimin e Provimeve të Shtetit për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, të Rregullores "Për funksionimin e Komisionit të Provimit të Shtetit për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë". Trajtimi financiar i anëtarëve të Komisionit të Provimit të Shtetit të kryhet sipas dispozitave në fuqi.

## Neni 11

### Përzgjedhja e bashkëpunëtorëve të tjerë

1. Procedura e përzgjedhjes së bashkëpunëtorëve të tjerë për të cilët është e pamundur të zbatohet legjislacioni për prokurimin publik do të zbatohet rregullimi i parashikuar në këtë nen.
2. Procedura e përzgjedhjes fillon me publikimin e njoftimit për shpalljen e nevojës për bashkëpunëtorë në faqen zyrtare të internetit të institucionit.
3. Njoftimi për shpalljen e nevojës për bashkëpunëtorë duhet të përmbajë:
  - a) listën e dokumenteve që duhen paraqitur;
  - b) informacion mbi shërbimin;
  - c) afatin e fundit dhe adresën ku duhet të paraqiten dokumentet.
4. Për kryerjen e procedurave të seleksionimit dhe përzgjedhjes të kandidatëve, Drejtori i Përgjithshëm i AKP-së me urdhër, ngre komisionin përkatës. Komisioni duhet të ketë në përbërje minimalisht 5 anëtarë, nga të cilët njëri duhet të jetë nga Drejtoria përkatëse ku duhet ofruar shërbimi dhe tjetri specialist i fushës përkatëse që ka lidhje me profilin e kandidatit si bashkëpunëtor. Komisioni vlerëson nëse procedura do të kryhet me konkurrim mbi bazën e dosjeve të kandidatëve apo me testim.
5. Në përfundim të procesit komisioni merr vendim për shpalljen e fituesit.
6. Anëtarët e Komisionit, përpara se të bëjnë përzgjedhjen e kandidatëve, duhet të nënshkruajnë një deklaratë që nuk ndodhen në kushtet e konfliktit të interesit me personat pjesëmarrës si bashkëpunëtorë të jashtëm.

## **Neni 12**

### **Vlerësimi i kandidatëve**

1. Komisioni shqyrton dosjet e kandidatëve dhe me vendim përcakton fituesit në përputhje me kriteret përkatëse.
2. Komisioni mban proces verbal lidhur me vlerësimin e të përzgjedhurve dhe shpall listën e fituesve.
3. Komisioni i merr vendimet me shumicën e votave të anëtarëve të tij.

## **Neni 13**

### **Shpallja e fituesve dhe lidhja e kontratave**

1. Pas shpalljes së rezultatit përfundimtar të fituesve në faqen e AKP-së, fituesit duhet të paraqiten jo me vonë se 5 ditë nga shpallja dhe të lidhin kontratën. Kontratat lidhen në përputhje me legjislacionin në fuqi.
2. Fituesit si bashkëpunëtorë të jashtëm do të lidhin kontratë-shërbimi me AKP-në.

## **Neni 14**

### **Të drejtat dhe detyrat e kandidateve – bashkëpunëtorë**

1. Bashkëpunëtorët gëzojnë të gjitha të drejtat që u njeh ligji dhe kontratat e lidhura si dhe kanë për detyrë të zbatojnë me përpikëri të gjitha detyrimet që burojnë nga legjislacioni në fuqi dhe kontrata.
2. Trajtimi financiar i bashkëpunëtorëve kryhet sipas dispozitave në fuqi.

## **Neni 15**

### **Konflikti i Interesit**

Të gjithë bashkëpunëtorët e AKP-së duhet të nënshkruajnë deklaratë që nuk janë në konflikt interesi sipas Ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005, "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", i ndryshuar.

## **Neni 16**

### **E drejta e Autorit**

1. Të gjithë bashkëpunëtorët e AKP-së duhet të veprojnë në përputhje të plotë me Ligjin nr.9380, datë 28.04.2005 "Për të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të", i ndryshuar.
2. Kur ata veprojnë në kundërshtim me Ligjin nr.9380, datë 28.04.2005, "Për të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të", i ndryshuar, dënohen sipas nenit 130 të këtij Ligji. Kur nuk përbëjnë vepër penale, konsiderohen kundërvajtje administrative veprimet ose mosveprimet e çdo personi fizik ose juridik për qëllim të drejtpërdrejtë ose të tërthortë fitimi, sipas rasteve të parashikuara në nenin 130 të këtij ligji.
3. Bashkëpunëtorët e AKP-së, kur veprojnë në kundërshtim me Ligjin nr. 9380, datë 28.04.2005, "Për të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të", i ndryshuar, përjashtohen nga lidhja e kontratave të tjera me AKP-në në të ardhmen.

## **Neni 17**

### **Mbrojtja e të dhënave personale**

Çdo bashkëpunëtor i AKP-së, që merret me përpunimin e të dhënave personale të subjekteve, detyrohet të zbatojë kërkesat e ligjit "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar dhe të akteve të tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi.

## **Neni 18**

### **Sanksionet**

1. Kjo Rregullore është pjesë e Rregullores së brendshme dhe mosrespektimi i kërkesave të saj përbën shkelje të disiplinës në punë dhe ndëshkohen sipas legjislacionit në fuqi.
2. Bashkëpunëtorët e AKP-së që nuk e realizojnë kontratën brenda afatit, përcaktimeve, kushteve dhe rregullave të rena dakord në këtë rregullore dhe kontratat e lidhura me ta përjashtohen nga lidhja e kontratave të tjera me AKP-në dhe zbatohen sanksionet sipas Rregullores së Ministrit përgjegjës për arsimin "Për procesin e Maturës Shtetërore në Republikën e Shqipërisë" dhe aktet e tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi.

## **Neni 19**

### **Publikimi**

Të gjitha njoftimet lidhur me procedurat e aplikimit do të gjenden në adresën e internetit të Agjencisë Kombëtare të Provimeve [www.akp.gov.al](http://www.akp.gov.al)

## **Neni 20**

### **Zbatimi i Rregullores**

Personeli i AKP-së dhe bashkëpunëtorët e jashtëm janë të detyruar të respektojnë kërkesat e kësaj Rregulloreje.

## **Neni 21**

### **Ndryshimi apo shfuqizimi**

Ndryshimet, amendimet apo shtesat e nevojshme në këtë Rregullore bëhen me propozim të Drejtorive të AKP-së dhe me miratimin e Drejtorit të Përgjithshëm të AKP-së. Ndryshimet, amendimet apo shtesat e nevojshme në këtë Rregullore hyjnë në fuqi pas miratimit nga Drejtori i Përgjithshëm i AKP-së.



## **Neni 22**

### **Parashikime të fundit**

Pas miratimit të kësaj Rregulloreje nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të AKP-së, çdo akt administrativ që rregullon çështjet e përzgjedhjes së bashkëpunëtorëve të jashtëm dhe që bie ndesh me këtë rregullore shfuqizohet.

## **Neni 23**

### **Hyrja në fuqi**

Kjo rregullore hyn në fuqi pas miratimit të saj nga Drejtori i Përgjithshëm i AKP-së.

**Shtojca nr. 1: Formimi i numrit unik të Certifikatës për hartuesit e fondit të pyetjeve/vlerësuesit në Provimet Kombëtare:**

1	4	C	H	F	0	0	0	0	1
		C	V	T					
Viti		Kodi			Numri individual				

**Viti:** përbëhet nga dy shifra të cilat tregojnë vitin e dhënies së provimit.

**Kodi** për hartuesit e fondit të pyetjeve është CHF (certifikatë hartues fondi).

**Kodi** për vlerësuesit e testeve është CVT (certifikatë vlerësues testi).

**Numri individual:** përbëhet nga pesë shifra të cilat tregojnë numrin individual të kandidatit duke filluar nga 00001 dhe vazhdojnë në rend rritës.

Shtojca nr. 2: Certifikata



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT**  
**AGJENCIA KOMBËTARE E PROVIMEVE**

---

**CERTIFIKATË**  
**e Hartuesit të Fondit të Pyetjeve,**  
**Vlerësuesit**  
**të Provimeve Kombëtare**

Në zbatim të Udhëzimit të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës nr.24, datë 02.08.2013, "Për certifikimin e hartuesve të fondit të pyetjeve dhe vlerësuesve të testeve në provimet kombëtare",

I lëshohet Z/Znj \_\_\_\_\_,

(Emër, Atësi, Mbiemër

Datëlindje

Vendlindje

Certifikata është e vlefshme për një periudhë pesëvjeçare nga data e lëshimit

**DREJTORI I PËRGJITHSHËM**



Datë: XX.XX.XXXX

Numri i lejes: XXXXXXXXXXXX